



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1161/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zymer Reçices vezhgues i qendres se vendvotimit fshati Llugali Komuna Lipjan, paraqitur kundër Kryesuesit të vendvotimit Faton Sefedinit (KVV) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për kuvend komunal për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor dhe Manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur më 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e vezhguesit të vendvotimit të fshatit Llugali të Komunes së Lipjanit Zymer Reçices

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Zymer Reçica vezhgues i qendres së votimit në të cilën pretendon se në qendren e votimit nr 1308E/02 kandidati Sylejman Reçica me nr 08 në listen zgjedhore nga rradhet e PDK-se i ka 34 vota, kurse në formular i figurojnë 14 vota, kështu që mendon se votat e kandidatit në fjale janë bartur të kandidatit tjetër.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga deshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se ka ndodhur manipulimi i votave gjate procesit Zgjedhor, vlerësohen si të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1161/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.